

BASHKIA TIRANË

Formulari nr. 3

[Datë 17.01.2025]

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Tiranë
Adresa Sheshi "Skenderbej", Tiranë
Tel/Fax 0035542256799
E-mail administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **"Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje"**.

Data e zhvillimit do të jetë **18.01.2025 ora 09.00** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

1. "Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë –Washington DC- Tiranë", si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Washingtonit, do të bëhet në datën 19.01.2025 në orën 06.00, mbërritja në orën 14.35.
- Kthimi nga Washingtoni drejt Tiranës do të bëhet në datën 22.01.2025, në orën 18.00, mbërritja në orën 14.15.

Me një ndalesë, bagazhe të përfshira.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.

**Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të

prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: administrative.prokurime@tirana.al) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.